

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“EAGLE SCP” Sh.p.k

Kreu I

THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi

Në Bulqizë, sot me datë **15 /04/2025**, unë Erald Laçi, atësia Bujar, amësia Adelina, shtetas shqiptar, i datëlindjes 24.02.1994, i lindur në Bulqizë dhe banues në adresën Rrugën “Maksut Drasa” Nd. 6, hyrja 4, njësia administrative nr. 9, kodi postar 1016, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër 033625276 dhe numër personal J40224011Q, me datë lëshimi 04.04.2018, i identifikuar me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj me vullnet të lirë e të plotë dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodit Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Per tregatatet dhe shoqerite tregare”, ligjin nr.9723, datë 03.05. 2007 “Per Regjistrimin e Biznesit” kam krijuar dhe hartuar statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emrin **“EAGLE SCP” SH.P.K.**

Neni 2

Objekti

Shoqëria ka si objekt kryesor të saj:

- Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim në fushën e ndertimeve civile, sociale, kulturore, ekonomike dhe industriale, ura vepra arti, ujsjelles kanalizime, riasfaltime dhe rruge të gjitha kategorive përfshi sinjalistikën, porte, aeroporte, hekurudha, kulte fetare, vepra hidraulike dhe hidroteknike, tunele, diga, depozitime dhe trajtime të mbetjeve të ngurta, rikonstruksione etj, punime topogjeodezike dhe gjeologjike, dhe vlerësimin e pasurive të paluajtshme.
- Veprimtari ekspertize lidhur me ndikimin në mjedis dhe auditim mjedisor.
- Studim dhe përgatitje e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndertesave të çdo lloji dhe hartim të akteve të ekspertizës për zjarret e rena.
- Shërbime të planifikimit urban.
- Përgatitje dhe hartim të dokumentave të vlerësimit të riskut, shërbime për sigurinë dhe shëndetin në punë, në fushën e ndertimeve dhe të shërbimeve.



- Zhvillim i planeve te sigurise, koordinimit, te ndihmes se pare dhe evakuimit.
- Import eksport, tregti me shumice dhe pakice te cfare do lloj veprimtarie tregtare dhe sherbimi qe lejohet nga legjislacioni shqiptar.

Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin.

Neni 3 **Forma Ligjore**

Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin gjatë aktivitetit të saj.

Neni 4 **Baza Ligjore**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji i Shoqërive Tregtare"), i ndryshuar dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

Neni 5 **Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

Shoqëria krijohet për të vepruar për një afat **te pacaktuar**, duke filluar nga data e regjistrimit të saj ne QKB, Tirane. Në përputhje me këtë statut, shoqëria mundet të mbylli veprimtarinë e saj kur e shihet e arsyeshme apo në rast se të parashikuara në ligj.

Neni 6 **Selia/Adresa e Regjistruar**

Shoqëria **"EAGLE SCP" Sh.p.k**, do të ketë seline e saj në qytetin e **Bulqizës, adresa Lagjia e Re, Zone Kadastrale 8611, vol.5, fq. 248, numer pasurie 1/9+1-2, Bulqize.**

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra përfaqësimi, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.



KREU II

Neni 7

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100,000 (njqind mije) lekë**.

Kapitali i mesiperm është nënshkruar nga "ortaku i vetem" i shoqërisë Erald Laçi dhe përbehet nga **1 (nje) kuote**, me vlerë të përgjithshme 100,000 (njqind mije) leke, që përben 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë. Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundërt të treqëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e shoqërisë.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të Vetem të shoqërisë në të njetat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 9

Kuotat dhe transferimi i tyre

Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723,



date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka karakter deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

Transferimi i kuaotave te te tretet kufizohet me miratimin e asamblese se ortakëve ne te njejtat kushte qe kerkohen ndryshimet ne Statut.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 10

Organi vendimarrës

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve ("Asambleja e Ortakëve"), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të shoqërisë si dhe të drejtat e siguruara nga ky statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimeve te Ligjit per shoqerite tregtare.

Vetëm Ortaku i Vetem do të ketë të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. Modifikimin dhe ndryshimin e këtij statuti;
- c. Të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;
- d. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- e. Të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
- f. Vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjetër të shoqërisë;
- g. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- h. Të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
- i. Të miratojë raportet vjetore dhe bilancet dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
- j. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. Të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë;
- l. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë ;
- m. Të vendosë pagën, shtesa në pagë dhe shperblimet e Administratorit;
- n. Të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
- o. Të vendosë mbi buxhetin vjetor;
- p. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- q. Të vendosë për çdo çështje tjetër, që i takon për zgjidhje asamblesë së ortakëve, me ligj dhe/ose sipas këtij statuti.



Te gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investimet;
- d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'ja kunderdrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 11

Administrimi i Shoqërisë dhe kompetencat e administratorit

Administrator i shoqerise eshte ortakut i vetem i shoqerise **ERALD LAÇI**, shtetas shqiptar, i datelindjes 24.02.1994, i lindur ne Bulqize dhe banues ne adresen Rrugën “Maksut Drasa” Nd. 6, hyrja 4, njësia administrative nr. 9, kodi postar 1016, Tiranë, mbajtes i leternjoftimit me numer 033625276 dhe numer personal J40224011Q. Ai eshte zgjedhur administrator per nje afat **5 vjeçar me te drejte riemerimi**.

Administratori mund te emerohet ose shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise dhe/ose te Asamblese se Ortakeve.

Administratoret e shoqërisë mund të shkarkohen nga pozicioni që ka në shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumice të Zakonshme. Në asnjë rast ortakëve nuk i duhet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ata shkarkojnë administratorin. Në cdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit.

Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.



Administratori ka të drejtat dhe detyrohet të:

- a. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
- b. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- c. përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave, pa miratim me shkrim nga ortaket;
- d. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- e. vlera e transaksioneve bankare që lejohet të kryhet nga administratori nuk do të kenë kufizim.
- f. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;
- g. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit, pa miratimit me shkrim nga ortaket;
- h. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
- i. administratori ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i tërheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbyllë marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet por në cdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërme, administratori duhet të marrë miratimin e me shume se 75% te kuotave te Ortakëve te Asamblesë.
- j. ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- k. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- l. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- m. thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së përgjithshme të Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
- n. të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata të tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga secili Ortak, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.
- o. administratori është i detyruar të therrase asamblenë e përgjithshme të Ortakëve në rastet kur:



- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- p. Te kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- q. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- r. çdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë kur te tretet nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është prove e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose te treteve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marreveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marreveshjen, për tu përballur në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit përkatës.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen:

- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;



- e) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;
- f) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- d) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) japin kredi.

KREU IV

VITI FINANCIAR – EKSPERTËT- BILANCI

Neni 13

Viti Financiar dhe Dividendi

Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetem vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.



Neni 14
Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar

Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 15
Bilanci, Mbajtja e Llogarisë

Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasues.

Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.

Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë barrë siguruese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm.

KREU V
PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 16
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë nga Ortaku i Vetëm dhe/ose Asambleja e Ortakëve me shumicë të cilësuar:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Ortakut të Vetëm dhe/ose Asamblesë së ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë ;



e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaku i vetem merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej shoqërisë emrin e likudatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesi i emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesit, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Ortaku i Vetem do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit.

Neni 17

Administrimi nga Likuiduesit

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Likuiduesi i nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut.

Neni 18

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.



Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 19

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit".

Neni 20

Largimi dhe përjashtimi i Ortakut

Largimi dhe përjashtimi i ortakut do të kryhet në përputhje me nenet 101, 102 dhe 103 të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

Neni 21

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijë m i një shoqërie të re.



Ndarja

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakut të Vetem, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligji nr. 9901 datë 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë:

- a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
- b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 22

Shndërrimi

Një shoqëri tregtare mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare.

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 23

Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.



Neni 23
Ndryshimet në Statut

Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Ortaku i Vetem dhe/ose Asambleja e Ortakëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 24
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25
Dispozita Përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplare me vlerë të njëjtte juridike në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnet të plote dhe të lire nga Ortaku Themelues.

ORTAKU I VETEM
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EAGLE SCP” Sh.p.k.

Z. Erald LAÇI

